



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos, më _____ .05.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Objekti i prokurimit: “Blerje karburanti (gazoil 10 ppm + benzinë pa plumb)”, me 2 lote

LOTI I: “Blerje gazoil 10 ppm”

LOTI II: “Blerje benzinë pa plumb”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **09134100-8**
Karburant diesel

VLERA E FONDIT LIMIT : 130,492,942 (njëqind e tridhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet e dy) Lekë pa TVSH, ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 20.05.2025) 1,334,830 (një milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë) Euro.

LOTI I: 130,130,957 (njëqind e tridhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 20.05.2025) 1,331,127 (një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e njëzet e shtatë) Euro.

LOTI II: 361,985 (treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH, ose fondin limit në euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH, datë 20.05.2025) 3,703 (tre mijë e shtëqind e tre) Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): 2.1.1.

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorezuar dokumentat sipas Kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

PER LOTIN 1.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit **për lotin/shumatores së loteve për të cilat konkurron.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit të lotit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.1. Autorizim (License) e vlefshme e stacionit të shitjes së karburanteve për ushtrimin e veprimtarisë, leshuar nga organi kompetent në zbatim të ligjit Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i licencuar në kryerjen e aktivitetit të vet për ofrimin tek AK të karburanteve.

2.3.2. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera ose me kontratë bashkepunimi të paktën 1 (një) stacion furnizimi me karburant brenda Qarkut Fier. Për këtë të paraqitet dokumenti i pronësisë, ose kontrata e qirase/bashkepunimit. Kontrata e qirase ose e bashkepunimit duhet të jetë të lidhura pranë noterit me afat vlefshmerie që të përfshijë afatin e ekzekutimit të kësaj kontrate dhe të shoqëruar me dokumentat e pronësisë dhe autorizimin e stacionit të shitjes së karburantit.

2.3.3. Ofertuesi duhet të sigurojë furnizim të pandërprerë, 24 orë në çdo ditë të javës në të paktën 1 (një) stacion furnizimi me karburant brenda Qarkut Fier. Ofertuesi duhet të sigurojë furnizimin edhe në rastet e emergjencave për karburant gjatë punimeve për eliminimin e avarive në vende që ndodhen larg pikave të furnizimit, aty ku autoriteti kontraktor ushtron veprimtarinë e vet. Ofertuesi duhet të deklarojë se mbulon furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “**Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme**”, Ofertuesi duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Në lidhje me këtë pikë ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër përbushjen e këtij detyrimi.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Këto kritere shërbejnë për të treguar se ofertuesit i kanë kapacitetet teknike lidhur me ekzekutimin e kontratës.

2.3.4. Flete analize ose raport analize i cilesisë për Gazoil 10 ppm, në përputhje me standardin shqiptar, leshuar nga Inspektoriti Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 germa c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar se karburanti i ofruar është në përputhje me standardin dhe plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi apo me qera te pakten 1 (nje) autobot me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 m3,

➤ **Pronesia** e autobotit te vertetohet si me poshte:

Ofertuesi duhet te paraqesë, lejen e qarkullimit te mjetit rrugor ne emer te ofertuesit, siguracion te vlefshem, akt kolaudimi te vlefshem, taksat vjetore.

➤ **Mjeti i marre me qira sipas pikes se mesiperme,** vertetohet me kontraten e qiramarrjes ose te huaperdorjes te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie qe perfshin edhe afatin e zbatimit te kesaj kontrate per kete objekt prokurimi dhe e shoqeruar me dokumentacionin, lejen e qarkullimit te mjetit rrugor, siguracion te vlefshem, akt kulaudimi te vlefshem, taksat vjetore.

➤ Per autobotin, operatori ekonomik duhet te paraqese edhe dokumentat e meposhtem :

- Çertifikate per transport mallrash te rrezikshme, leshuar nga Autoriteti perkates i caktuar me ligj.
- Pashaporten e cisternes per autobotin.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme eshte përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5 gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar kapacitetin teknik lidhur me mjetet në dispozicion të ofertuesit për të realizuar me sukses kontratën pasi sipas termave të kontratës ofertuesit duhet të ofrojnë shërbim për furnizim me karburant 24 orë si dhe të lëvrojnë karburantin në lëng në vendet e përcaktuara të Autoritetit Kontraktor.

PER LOTIN 2.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, te konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron vjetore te realizuar ne tre vitet e fundit 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se 40% te vlerës se fondit limit të lotit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit të lotit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Autorizim (License) e vlefshme e stacionit të shitjes së karburanteve për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga organi kompetent në zbatim të ligjit Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i licencuar në kryerjen e aktivitetit të vet për ofrimin tek AK të karburanteve.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira ose me kontratë bashkepunimi të pakten 1 (një) stacion furnizimi me karburant brenda Qarkut Fier. Për këtë të paraqitet dokumenti i pronësie, ose kontrata e qirash/bashkepunimit. Kontrata e qirash ose e bashkepunimit duhet të jetë të lidhura pranë noterit me afat vlefshmerie që të përfshijë afatin e ekzekutimit të kësaj kontrate dhe të shoqëruar me dokumentat e pronësisë dhe autorizimin e stacionit të shitjes së karburantit.

2.3.4 Ofertuesi duhet të sigurojë furnizim të pandërprerë, 24 orë në çdo ditë të javës në të pakten 1 (një) stacion furnizimi me karburant brenda Qarkut Fier. **Ne lidhje me këtë pikë ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër përmbushjen e këtij detyrimi.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Këto kritere shërbejnë për të treguar se ofertuesit i kanë kapacitetet teknike lidhur me ekzekutimin e kontratës.

2.3.5 Flete analize ose raport analize i cilesise per Benzine pa plumb, ne perputhje me standartin shqiptar, leshuar nga Inspektoriti Shteteror Teknik dhe Industrial.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme eshte përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar se karburanti i ofruar është në përputhje me standartin dhe plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit. Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë argumentuar dhe miratuar me procesverbal të vecantë të mbajtur nga specialistët e fushës të ngarkuar me urdhër të brendshëm. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Njësia e Prokurimit: